

SEMINAR NË KUADËR TË DITËS NDËRKOMBËTARE TË FILOZOFISË ME TEMË: “FILOZOFIA SI MËNYRË JETESE”

Në kuadrin e “Ditës Ndërkombëtare të Filozofisë”, Universiteti “Fan S. Noli”, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane; *Departamenti i Shkencave Sociale, në vitin e pestë* të organizimit të sesioneve shkencore organizoi në datën **30.11.2017**, seminarin:

“ Filozofia si mënyrë jetese ”

Këtë vit, u vlerësua si fushë me interes promovimi i kësaj disipline, jo vetëm për faktin se Filozofia është një nga disiplinat unike në objektin e studimit dhe metodën e lëvrimin të mendimit reflektiv dhe krijues, duke krijuar dhe orientuar mundësi të shumta në tregun e punës, por edhe sepse përkon me 15-të vjetorin e çeljes së Degës Filozofi-Sociologji, në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë. Fjalën përshendetëse në këtë seminar e mbajti përfaqësuese e rektoratit, Zv/Rektore Majlinda Bello.

Filozofia është konsideruar si baza e shkencave të tjera. Shpesh ajo është vendosur në pemën e diturive, si “ nëna e të gjitha shkencave” apo edhe “ shkencë e shkencave”. Objekt i studimit të saj është natyra, njeriu dhe marrëdhëniet e natyrës me njeriun. Si pjesë të studimeve të saj ajo evidenton tërësinë e vlerave, kuptimeve, ideve, idealeve e synimeve. Ajo përbën një lloj njohjeje të veçantë që ndryshon nga njohjet e thjeshta në formën e opinioneve apo edhe nga njohjet shkencore tërësisht eksperimentale. Njohja filozofike e ka burimin në karakteristikat që i atribuohen mendimit filozofik; i cili është jo vetëm reflektiv dhe kritik, por karakterizohet edhe nga funksioni analitik e sintetik; ndaj dhe i shërben përpjekjes për të kuptuar fenomenet e botës në çdo kohë, edhe në ditët e sotme. Nëse do t’i referoheshim njërit prej përfaqësuesve të mendimit filozofik, Emanuel Kantit, do të evidentonim se ai e ka përkufizuar filozofinë si: “ *një formë të angazhimit intelektual që pretendon ta legjitimojë vetveten me arsye racionale*”.

Nisur nga idetë mësipërme, të prezantuara nga Dekani i FSHNH-së, profesor i Filozofisë, Prof. dr. Gjergji Pendavinji, u mbajtën dhe gjashtë kumtesa. Ato u përgatitën nga specialistë të fushës: nga Universiteti i Tiranës, Prof. Dr. Gjergj Sinani “ Doctor Honoris Causa” i Universitetit “Fan S. Noli” Korçë; nga Universiteti i Elbasanit, Prof. as.dr. Arben Haxhiymeri; nga përfaqësuese e Gjimnazit “Raqi Qirinxhi” Korçë, mësuese dhe ZV/drejtoreshë Tefta Tako, pedagogë të departamentit të Shkencave Sociale, si dhe studente e programit “ Master Shkencor në Filozofi Sociale”, Ina Kosta.

